



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 770 Prot.

Tiranë, më 19.07 2016

VENDIM Nr. 77, datë 15.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9 të datës 15.07.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kërkime arkeologjike të Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës në Luginën e Sipërme të Vjosës"* paraqitur nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti i Shkencave Humane, Elbasan, miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Humane, drejtues Prof. As Ylli Cerova (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra e Studimeve Albanologjike-Ballkanologjike, Elbasan), Arditi Miti (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë), Eglantina Serjani (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kërkime arkeologjike të Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës në Luginën e Sipërme të Vjosës"* paraqitur nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti i Shkencave Humane, Elbasan, miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Humane, drejtues Prof. As Ylli Cerova (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra e Studimeve Albanologjike-Ballkanologjike, Elbasan), Arditi Miti (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë), Eglantina Serjani (Qendra e Kërkimeve dhe Promovimit të Peisazheve Historiko-Arkeologjike Shqiptare, Tiranë), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Survej arkeologjik i cili do të jetë i përqëndruar në terrenet fushore dhe formacionet kodrinore flishore, në të dy krahët e Luginës së Sipërme të Vjosës. Periudha e kryerjes sëurvejës do të jetë 15 shtator deri 15 tetor 2016.
 - Kryerja e 5 sondazheve arkeologjike në sitin e Magjericës. Periudha kohore e kryerjes së tyre do të jetë 15 gusht deri 15 shtator 2016.
2. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO